



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Nr. 1534/prot.

Tiranë, më 17.09.2020

Lënda: Kërkesë bashkëpunimi për votimin e shtetasve jashtë vendit

**AGJENSISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT**

Adresa: Rruga "Papa Gjon Pali i II", Nr 3,1003 Tiranë

Në zbatim të Ligjit Nr.10019, Datë 29.12.2008, i ndryshuar me Ligjin Nr.74/2012, Ligjin Nr.31/2015 dhe Ligjin Nr.101/2020 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" neni 25, pika 1, "Pavarësisht nga procedura e votimit, manuale apo elektronike, votat e votuesve jashtë vendit administrohen nga KQZ-ja, duke garantuar integritetin e votimit dhe fshehtësinë e votës nga çdo ndërhyrje mbi fletët e votimit ose mbi informacionin elektronik të votimit që administrohet prej saj", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vlerëson domosdoshmërinë e mbështetjes nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit në funksion të ndryshimeve ligjore të votuara në Kuvendin e Shqipërisë.

Mbështetja për realizimin e zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë edhe për shtetasit që jetojnë jashtë vendit kërkon aplikimin e platformave Tuaja mbi modele funksionale dhe të provuara në vendet e tjera për të garantuar verifikimin e kërkesës së zgjedhësve jashtë vendit si dhe elementët e sigurisë që do të ketë procesi i votimit.

Nga sa më sipër, Ju lutem mund të na informoni për mundësitë dhe përgatitjet Tuaja si institucion në lidhje me platformën që mund të përdoret për të drejtën ligjore të zgjedhësve jashtë vendit.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin

Ylli MERKAJ

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**  
**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**

Kopje: 3  
Afati i ruajtjes: 5 vjet

KQZ/DKZTEZ/A. Tenolli

KQZ/DTI/N. Mezani

